



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit Rajonal e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZhR), në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi-Hashani, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Sylaj udhëheqës i ekipit, Bahri Statovci dhe Mazlumsha Sejfadini anëtarë, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinion i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	21
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	24

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të MZHR-së të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (RVF) për vitin 2019, që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalesjet për këto pasqyra janë të plota dhe të sakta.

Menaxhimi financiar dhe kontrollat e brendshme në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, mirëpo kërkohet më tepër punë për të eliminuar mangësitë e identifikuara në disa fusha.

Ministria i është përgjigjur pozitivisht rekomandimeve të vitit paraprak, ku është vërejtur një angazhim i shtuar në adresimin dhe monitorimin e tyre.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të raportit.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministria është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së MZHR-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MZHR-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemin e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe çështjen e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet e brendshme të MZHR-së në përgjithësi janë zbatuar nga menaxhmenti dhe janë treguar efektive në parandalimin e parregullsive. Megjithatë, mos zbatimi me konsistencë i rregullave dhe obligimeve statutores, ka shkaktuar mangësi në menaxhimin e investimeve kapitale, subvencioneve pasurive dhe detyrimeve kontingjente.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	5,979,529	5,829,527	5,147,388	88	3,526,175	29,631
Granti i Qeverisë - Buxheti	4,779,529	4,650,935	4,261,517	92	3,526,175	29,631
Të hyrat nga AKP ³	1,200,000	1,178,592	885,871	75	0	0

Buxheti final i MZHR-së në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 150,002€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur bazuar në vendimet e qeverisë për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore: vendimi 02/113 i datës 05.11.2019 dhe vendimi 03/115 i datës 17.12.2019. Detajet janë paraqitur në paragrafët vijues pas tabelës 2.

Në vitin 2019, ministria kishte shpenzuar 88% të buxhetit final ose 5,147,388€, me një rënie prej 8% krahasuar me vitin 2018. Kjo kishte ardhur si rezultat i mos përmbushjes së projekteve kapitale të cilat janë bashkë-financuar me komunat. Barra bie mbi komunat për shkak se sipas marrëveshjes me MZHR-në kanë qenë të obliguara të zhvillojnë procedurat e prokurimit dhe të angazhohen në përmbylljen e projektit në vitin aktual fiskal.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive Rajonale:	5,979,529	5,829,527	5,147,388	88	3,526,175	29,631
Pagat dhe Mëditjet	418,169	374,101	374,101	100	305,837	21,897
Mallrat dhe Shërbimet	350,000	330,000	285,100	86	236,727	7,734
Shërbimet komunale	11,360	6,560	5,095	78	1,678	0
Subvencionet dhe Transferet	2,500,000	2,497,060	2,472,541	99	1,447,179	0
Investimet Kapitale	2,700,000	2,621,806	2,010,551	77	1,534,754	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje për dallim nga buxheti fillestar ishte zvogëluar për 44,068€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019, për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 20,000€, krahasuar me buxhetin fillestar me vendim të qeverisë nr. 02/113 të datës 05.11.2019 për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore;
- Tek shpenzimet komunale buxheti ishte zvogëluar për 4,800€, me vendim të qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,940€, me vendimin e qeverisë 03/115 të datës 17.12.2019; dhe
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte zvogëluar për 78,194€. Zvogëlimi ishte bërë me vendim të qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019, për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 374,101€. Numri i lejuar i të punësuarve sipas ligjit të buxhetit ishte 54, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund vitin 2019 ishte 48. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar nëntë të rinj. Kemi testuar 14 mostra për teste substanciale në vlerë 9,182€, si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë në vlerë 5,413€. Nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunalit në vitin 2019 ishte 336,560€, prej tyre ishin shpenzuar 290,195€. Shpenzimet kishin të bëjnë me: shërbime kontraktuese, udhëtime zyrtare, derivate, telefon, internet, etj. Kemi testuar 11 mostra për teste substanciale në vlerë 44,382€ si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë. Nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi.

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Në vitin 2019 buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 2,497,060€, prej tyre ishin shpenzuar 2,472,541€. Subvencionet janë dhënë për ndërmarrje të reja dhe ekzistuese/të vogla të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Qëllimi ishte krijimi i vendeve të reja të punës dhe stimulimi i ndërmarrjeve me potencial të rritjes. Gjithashtu, në vlerë më të vogël ishin mbështet edhe disa OJQ të cilat kontribuojnë në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Kemi testuar 88 mostra për teste substanciale në vlerë 907,030€, dhe 12 mostra për testime të pajtueshmërisë.

Çështja A1 – Kritere jo të qarta në udhëzuesin për grantet

Gjetja Sipas Udhëzuesit për aplikantët e granteve, ministria kishte bërë shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare të ndërmarrjeve të reja, ekzistuese (deri në dy vjet⁴) dhe të vogla. Në këtë udhëzues përkrahja ishte ndarë në tri Lote, mirëpo nuk ishin specifikuar qartë kriteret lidhur me statusin e klasifikimit të ndërmarrjeve. Në mungesë të sqarimeve të duhura, aplikantët kishin dërguar pyetje lidhur me kriteret klasifikuese. Ministria ishte përgjigjur përmes një dokumenti të publikuar në ueb faqen e saj ku kishte dhënë sqarime për kushtet që duhet plotësuar për tu kategorizuar në secilin Lot, duke u bazuar në Ligjin për investimet e huaja nr. 04/L-220. Sipas këtij ligji ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzetënëntë (49) punëtorë. Megjithatë, ky ligj nuk e rregullon fushën granteve të dhëna nga buxheti i Kosovës.

Për më tepër, në dy raste kemi gjetur se ministria kishte mbështetur me grante ndërmarrjet të cilat kishin të punësuar mbi 49 punëtorë, e të cilat (sipas ligjit në të cilin janë thirrur në përgjigjet ndaj aplikantëve) konsiderohen ndërmarrje të mesme. Njëra ndërmarrje ishte përkrahur me 24,500€⁵ dhe tjetra 15,000€⁶.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos qartësisë së kriterëve në udhëzuesin për aplikim të granteve.

Ndikimi Marrja e granteve nga ndërmarrjet e mesme ndikon që fondet të shpenzohen në kundërshtim me objektivat dhe qëllimin e ministrisë për stimulimin e bizneseve të reja dhe të vogla.

Rekomandimi A1 Ministri të sigurojë se janë vendosur kritere të qarta në udhëzuesin për aplikantët duke shmangur thirrjen në ligjet të cilat nuk mbulojnë fushëveprimin e aktiviteteve të ministrisë, si dhe të sigurojë se financimi bëhet vetëm për ndërmarrjet që parashihen sipas udhëzuesit.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,621,806€, prej tyre në vitin 2019 ishin shpenzuar 2,010,551€. Ato kanë të bëjnë me investimet kapitale në komuna për projekte të ndryshme si: ndërtimin e trotuareve, infrastrukturës sportive, ujësjellësit, ndërtesave administrative, rregullimin e shtratit të lumenjve. Kemi testuar 44 mostra për teste substanciale në vlerë 1,957,670€ si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë.

⁴ Ndërmarrje ekzistuese të vogla;

⁵ 55 punëtor i kishte të deklaruar në ATK dhe

⁶ 71 punëtor i kishte të deklaruar në ATK.

Çështja A2- Përkrahja e projekteve kapitale të komunave jo në pajtim me kërkesat e udhëzuesit për aplikantë

Gjetja Një ndër kriteret e përcaktuara për përkrahjen (financimin) e projekteve kapitale komunale sipas Udhëzuesit për Aplikant Programi për Zhvillim Rajonal 2019, ishte që projekti të jetë i ri dhe jo vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër.

Ne kemi vërejtur se MZHR përmes aneks marrëveshjeve të mirëkuptimit për bashkëfinancim të lidhura me komunat gjatë viti 2019, kishte përkrahur 6 projekte⁷ kapitale të vitit 2018, në vlerë 319,884€. Projektet e financuara ishin vazhdimësi nga viti 2018 dhe jo projekte të reja ashtu siç kërkohet me udhëzues. Vlen të theksohet se projektet e njëjta ishin përkrahur nga MZHR edhe gjatë vitit 2018, ku sipas marrëveshjeve të bashkëfinancimeve projektet është dashur të përfundojnë në vitin 2018, dhe pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të komunës. Kjo ka ndodhur nga papërgjegjësia e menaxhmentit të ministrisë për t'i respektuar kërkesat e dala nga Udhëzuesi për Aplikant.

Ndikimi Nënshkrimi i aneks kontratave me komunat të cilat nuk kishin arritur të përfundojnë projektet në vitin e paraparë ka ndikuar në zvogëlimin e buxhetit për projekte të reja dhe në diskriminimin e komunave të cilat kanë treguar performancë të mirë në realizim.

Rekomandimi A2 Ministri të sigurojë se në të ardhmen përkrahen vetëm projektet e reja kapitale sipas kriteve të udhëzuesit, si dhe nuk do të lidhë asnjë aneks marrëveshje të bashkëfinancimit me komunat për projektet që janë vazhdimësi nga vitet paraprake.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Raportin Vjetor Financiar (RVF) e pasurive kapitale ishte 1,991,956€, e pasurive jokapitale 15,338€, si dhe e stoqeve 28,925€. Kemi testuar 51 mostra për teste substanciale në vlerë 2,324,816⁸, si dhe mostra për teste të pajtueshmërisë.

⁷ Shtigjet e ecjes- me Komunën e Rahovecit, Ndërtimi i infrastrukturës së parkut për sport në Komunën e Skenderajt, Rregullimi i terreneve sportive në rajonin e Lumëbardhit, Përmirësimi i jetës në qytetarëve- Qamëri-Kamenicë, Qendra për zhvillim dhe avancim në Pejë dhe Ndërtimi i kolektorëve kryesorë Glllogoc-Skenderaj.

⁸ Në vlerën e testuar janë përfshirë pasuritë e vitit 2019, transferimi i pasurive kapitale tek komunat përfituese, si dhe testimi i saldove të pasurive për vitin paraprak.

Çështja B1- Mos bartja e pronësisë së pasurive tek përfituesi

E gjetura Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurisë Jo-financiare, neni 12 thekson se Organizatat Buxhetore (OB) mund të blejnë dhe ndërtojnë pasuri përmes bashkëfinancimit, të cilat regjistrohen si investime në vijim tek OB financuese. Në momentin kur pasuria jofinanciare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, OB financuese do ta mbyllë llogarinë e investimeve në vijim dhe organizata pranuese e regjistron pasurinë e pranuar në regjistrat e saj.

MZHR në vitin 2019 kishte financuar projektin “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatrat, Dush, Jellovc, Dellovicë dhe Grabanicë” në vlerë 130,000€, ndonëse ishte bërë pranimi teknik nga ana e komunës më 17.12.2019, nuk kishte bërë bartja e pasurisë në regjistrin e komunës përfituese. Kjo pasuri figuronte si investime në vijim, duke mbivlerësuar pasurinë kapitale.

Mos largimi i projektit nga regjistri i pasurive kapitale kishte ndodhur pasi që zyrtari i pasurisë nuk kishte siguruar me kohë dokumentin e pranimi teknik të projektit si dhe dokumentacionin e pagesës.

Ndikimi Mos bartja e pasurisë në regjistrat e komunave përfituese, ka ndikuar që pasuria kapitale e ministrisë të mbivlerësohet në RVF.

Rekomandimi B1 Ministri të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara si investime në vijim, pas përfundimit të procedurave të pranimi teknik, barten si pasuri në regjistrat e organizatave buxhetore përfituese, dhe të njëjtat largohen nga regjistrat e pasurive të ministrisë.

Çështja A3- Raportim jo i saktë i pasurisë jokapitale

Gjetja Neni 19.3.2-Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€, i RVF kërkon që pasuritë nën 1,000€ të prezantohen në vlera të plota dhe të sakta.

Ne kemi vërejtur se ministria në RVF neni 19.3.2 te pasuritë jokapitale (vlera nën 1000€) kishte shpalosur vetëm blerjet e vitit 2019. Pasuritë jokapitale në fund të vitit 2019 është dashur të raportohen në vlerë 48,666€, ndërsa janë raportuar në vlerë 15,338€, duke i nënvlerësuar pasuritë për 33,328€.

Sipas ZKF ky lëshim kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë gjatë përpilimit të RVF.

Ndikimi Mos raportimi i saktë i pasurisë jokapitale ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë në RVF.

Rekomandimi A3 Ministri, duhet të ndërmerri masa për të siguruar që vlera e pasurive jo kapitale në RVF të përfshijë vlerën kumulative të pasurive që i takojnë organizatës dhe jo vetëm vitin aktual.

Çështja A4 – Kryerja e inventarizimit të pasurisë para përfundimit të vitit

Gjetja Rregullorja MF. nr. 02/2013 Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB paragrafi 4.7 përcakton se: Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare duhet të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në MZHR kishte hartuar raportin më datë 18.09.2019, katër muaj para dorëzimit të RVF.

Kryerja e procesit të inventarizimit më herët kishte ndodhur për shkak se zyrtarët kompetent nuk kishin njohuri të duhura për rregulloren mbi menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Kryerja e inventarizimit para kohe ka vështirësuar menaxhimin efektiv të pasurisë dhe për rrjedhojë vlera e pasurisë e paraqitur në RVF nuk ishte e saktë.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj se inventarizimi i pasurisë kryhet në fund të vitit për të siguruar informata të sakta dhe të plota të pasurisë së ministrisë para përgatitjes së raportit vjetor financiar.

2.3 Detyrimet e papaguara dhe kontingjente

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, të prezantuara në PVF të e organizatës ishte 9,593€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Për qëllime të testimit substancial, ne kemi testuar pesë (5) mostra në vlerë totale prej 7,226€, të cilat ishin paguar në fillim të vitit 2020. Po ashtu ne kemi verifikuar se MZHR kishte raportuar në Ministrinë e Financave në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara.

Obligimet e papaguara kishin të bënin me dreka zyrtare, shpenzime të ujit dhe rrymës dhe shpenzime të qirasë për automjete dhe ndërtesë. Faturat ishin pranuar në fund të muajit dhjetor dhe pas përmbylljes së Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiare të Kosovës (SIMFK). Këto ishin arsyet pse këto fatura nuk janë proceduar për pagesë në vitin 2019.

MZHR në fund të vitit 2019 ka paraqitur detyrimet kontraktuale me vlerë 67,339€, të cilat do të ngarkojnë buxhetin e vitit 2020. Këto detyrime kanë të bëjnë me kontrata të nënshkruara gjatë vitit aktual 2019.

Çështja A5- Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 18 i Rregullores MF - Nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar kërkon që organizatat buxhetore të raportojnë detyrimet kontingjente.

Ministria kishte shpallur në RVF detyrime kontingjente në vlerë prej 4,800€, të cilat për nga natyra nuk ishin detyrime kontingjente, por pasuri kontingjente. Kjo Ministria kishte kërkuar nga një biznes i subvencionuar më parë, kthimin e mjeteve meqë nuk kishte përmbushur obligimin e saj sipas kontratës. Kjo për shkak se përfituesi nuk e kishte përdorur investimin sipas qëllimeve për të cilin ishte subvencionuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive profesionale të zyrtarëve lidhur me mënyrën e paraqitjes të hyrave kontingjente.

Ndikimi Shpallja vlerave të tilla në RVF përveç që nuk është e saktë ndikon që shfrytëzuesit e RVF të keq informohen lidhur me detyrimet kontingjente.

Rekomandimi A5 Ministri të siguroj se shpallja e pasurive/detyrimeve kontingjente të bëhet në pajtim me formën e tyre ligjore përkatëse sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

MZHR, nuk ka formuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Mirëpo bazuar në kërkesën e saj një auditim ishte kryer nga Departamenti Auditimit Brendshëm /Ministria e Financave. Objektivi e auditimit ishte planifikimi i buxhetit, realizimi i shpenzimeve në mbështetje të funksionimit të ministrisë, menaxhimi i personelit dhe pasurisë. Në këtë raport ishin dhënë tri (3) rekomandime, të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të MZHR-së. Ministria kishte përgatitur planin për adresimin e rekomandimeve, ku ishin përcaktuar afatet dhe zyrtarët përgjegjës për adresimin e rekomandimeve.

Duhet të theksohet se aktualisht MZHR ka dërguar një zyrtarë për tu trajnuar në fushën e auditimit të brendshëm, i cili është në proces të certifikimit.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të MZHR-së ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime. MZHR kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi Zbatimin e Rekomandimeve (30) shtator dhe 15 mars), sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, gjashtë rekomandime janë zbatuar, një nuk është zbatuar dhe dy rekomandime janë të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (Tabela e Rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
A1	PFV	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë kapitale tek komunat për projektet e përfunduara, por që ende gjenden në regjistrin e pasurive të ministrisë. Gjithashtu, të siguroj se edhe procesi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale është kryer sipas kërkesave ligjore dhe të gjitha obligimet e pa paguara janë prezantuar drejt në PFV.	Megjithëse ministria ishte angazhuar që një numër i madh i pasurive të barten tek komunat, përsëri kishte mangësi.	Rekomandim i pazbatuar
A2	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri, të siguroj se në rastin e caktimit të menaxherëve të kontratës, të respektohet parimi i ndarjes së detyrave.	Ministria ishte angazhuar të bëjë ndarjen e drejtë të detyrave. Nuk kemi hasur raste të tilla për vitin 2019.	Rekomandim i zbatuar
A3	Investimet kapitale	Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura dhe se gjatë procesit të vlerësimit të projekteve për financim nga ministria, përmes formimit të një komisioni profesional, duhet të respektohen në mënyrë rigoroze kriteret e vendosura dhe dokumentacionit mbështetës që siguron realizimin e projektit.	Komisioni i formuar nga ministria gjatë vitit 2019 kishte bërë vlerësimin në pajtim me kriteret e vendosura.	Rekomandim i zbatuar

A4	Investimet kapitale	Ministri, duhet të siguroj mekanizma më efektiv të mbikëqyrjes ndaj procesit të vlerësimit dhe të siguroj se kriteret aplikohen njëjtë ndaj të gjithë aplikuesve.	Komisioni i formuar nga ministria gjatë vitit 2019 kishte bërë vlerësimin në pajtim me kriteret e vendosura.	Rekomandim i zbatuar
A5	Investimet kapitale	Ministri, të siguroj se procesit të realizimit të pagesave i paraprin një kontroll i detajuar duke siguruar se dokumentacioni është i plotë bazuar në kushtet e marrëveshjeve të mirëkuptimit.	Ministria ishte angazhuar që për secilën kontratë të ketë siguri valide të ekzekutimit.	Rekomandim i zbatuar
A6	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të rris masat e përgjegjësisë ndaj komisionit të inventarizimit të pasurisë, në mënyrë që raporti i përgjithshëm i inventarizimit të dorëzohet në kohën para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, ashtu që ndryshimet e mundshme të identifikuar të cilat përcaktohen pas inventarizimit, të pasqyrohen në regjistrat e pasurisë.	Për vitin 2018 komisioni kishte vonuar hartimin e raportit të inventarizimit përderisa në vitin 2019 kishte hartuar raportin e inventarizimit shumë më herët se sa të përgatitet RVA me ç'rast kemi rekomandim të ri.	Rekomandim i mbyllur

A7	Obligimet e papaguara	Ministri të sigurojë së janë ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me informimin apo trajnimin e stafit sa i përket rregullave të thesarit dhe të siguroj zbatimin e një procesi të rregullt të evidentimit të faturave dhe raportimit të rregullt të obligimeve të papaguara.	Të gjitha faturat e papaguara janë raportuar dhe protokolluar.	Rekomandim i zbatuar
A8	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa, në mënyrë që shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen përmes themelimit të NjAB-së brenda ministrisë.	Ministria e Financave kishte kryer një auditim për MZhR dhe një zyrtarë është në proces të certifikimit.	Rekomandim i zbatuar
A9	Raportimi menaxherial.	Ministri të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë dhe ecuritë buxhetore, përfshirë edhe shpenzimet si subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, identifikimi i rreziqeve të bëhet në nivel të departamenteve dhe të merren masa për menaxhimin e tyre duke përfshirë raportimin/rishikimin e regjistrit në baza të rregullta (tre mujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprime ashtu siç është planifikuar.	Menaxhmenti është angazhuar në këtë drejtim.	Rekomandim i mbyllur
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Kritere jo të qarta në udhëzuesin për grantet	Ministri të sigurojë se janë vendosur kritere të qarta në udhëzuesin për aplikantët duke shmangur thirrjen në ligjet të cilat nuk mbulojnë fushëveprimin e aktiviteteve të ministrisë, si dhe të vendos kontrolle efektive me qëllim të sigurimit se financimi bëhet vetëm për ndërmarrjet që parashihen sipas udhëzuesit.		
A2	Përkrahja nga MZhR të projekteve kapitale të	Ministri të sigurojë se në të ardhmen përkrahen vetëm projektet e reja kapitale sipas kriterëve të udhëzuesit, si dhe nuk do të lidhë asnjë aneks marrëveshje të bashkëfinancimit me komunat për projektet që janë vazhdimësi nga vitet paraprake.		

	komunave jo në pajtim me kërkesat e udhëzuesit për aplikantë	
B1	Mos bartja e pronësisë së pasurive tek përfituesi	Ministri të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara si investime në vijim, pas përfundimit të procedurave të pranimit teknik, barten si pasuri në regjistrat e organizatave buxhetore përfituese, dhe të njëjtat largohen nga regjistrat e pasurive të ministrisë.
A3	Raportim jo i saktë i pasurisë jokapitale	Ministri, duhet të ndërmerr masa për të siguruar që vlera e pasurive jo kapitale në RVF të përfshijë vlerën kumulative të pasurive që i takojnë organizatës dhe jo vetëm vitin aktual.
A4	Kryerja e inventarizimit të pasurisë para përfundimit të vitit	Ministri duhet të siguroj se inventarizimi i pasurisë kryhet në fund të vitit për të siguruar informata të sakta dhe të plota të pasurisë së ministrisë para përgatitjes së raportit vjetor financiar.
A5	Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente	Ministri të siguroj se shpalosja e pasurive/ detyrimeve kontingjente të bëhet në pajtim me formën e tyre ligjore përkatëse sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTRIJSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT ARHIVA / ARHIVA / ARCHIVE DALËSE / DALËSE / OUTGOING	
Nr. Dokumenti / Doc. No. / No. Dokument 03	Klasifikimi / Classif. / Classif. Code 47		Nr. Protokollit / Prot. No. / Prot. No. 1172	Nr. Fletëve / No. Pages / No. Pages 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Enis Kervan 

Ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal,

Data: 21 Korrik 2020, Prishtinë,